



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:163819
Datë: 18.03.2024
Numri i dokumentit: 05472886

Ac.nr.4070/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci – kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli Prishtinë, kundër të paditurit H.(H.) M., nga fshati S., Komuna e Podujevës, me objekt kontesti për rimbursim dëmi, vlera e kontestit 653.00 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, C.nr.125/2017, të datës 25.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurit H.(H.) M., nga fshati S., Komuna e Podujevës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, C.nr.125/2017, i datës 25.02.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.125/2017, të datës 25.02.2021, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET në tersi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë dhe DETYROHET i paditurit H.H.M. nga fshati S., K. Podujevës, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit - borxhit të shkaktuar të dëmtuarës në aksidentin e dt.15.06.2013, në shumën prej 653.00 euro me kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste të R. Kosovës, për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive.

II. Shumën e aprovuar i padituri detyrohet t’ia paguaj paditëses në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

III. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës paditëse që kamata të llogaritet nga dita e ushtrimit të padisë në gjykatë deri në pagesën definitive.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë i padituri dhe atë për shkak të shkeljes të së drejtës materiale, shkeljes të së drejtës procedurale, të fakteve të gabuara, të shkeljes të së drejtës ligjore dhe parashkrimit, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovon si të bazuar ankesën e të paditurit dhe ta hedh poshtë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, C.nr.125/2017, të datës 25.02.2021, si të pabazuar, pasi që kërkesa për borxh është parashkruar sepse kanë kaluar me tepër së tre vite nga dita e pagesës së palës së tretë dhe ngritjes së padisë.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurit.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, me datë 16.03.2017, në Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, ka paraqitur padi, kundër të paditurit H.(H.) M., nga fshati S., Komuna e Podujevës. Në referatin e padisë ka parashtruar së i padituri me datë 15.06.2013, rreth orës 09:15, në Podujevë, ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin VW Golf , me targa ..., si pasoj e këtij aksidenti ka pësuar dëm e dëmtuara A.Sh. V. Ka theksuar së automjeti i cili ishte shkaktar i aksidentit në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë pa mbulesë siguroese, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit. Ndërsa paditësja duke i respektuar dispozitat e Ligjit të 04/L-018 për Sigurim të Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, dhe të dispozitave të LMD-së, të dëmtuarës A.Sh. V., ia ka kompensuar dëmin e pësuar në këtë aksident. Në fund ka kërkuar që t'i rimburohet shuma prej 653.00 euro, të cilën shumë paditësja ia ka kompensuar të dëmtuarit, me arsyetim se i padituri ka qen shkaktar i aksidenti dhe se i njëjti nuk ka pasur sigurim.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.125/2017, të datës 06.11.2020, e ka detyruar të paditurin që në afat prej 15 ditëve të paraqet përgjigje në padi, ndërsa i padituri me datë 18.11.2020, ka paraqitur përgjigje në padi me të cilën ka kërkuar nga gjykata që padinë e paditëses ta hedhë në tërësi me arsyetimin së nuk ka mundësi financiare ta paguaj shumën e kërkuar pasi që nuk punon askund dhe është në gjendje të rënd materiale.

Gjykata e shkallës së parë pas pranimit të përgjigjes në padi, duke konsideruar se janë plotësuar kushtet ligjore konform nenit 152 të LPK-së, ka marrë aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka konstatuar se i padituri edhe përkundër kontestimit të kërkesëpadisë i njëjti i ka pohuar faktet vendimtare, dhe gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestimore nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor pasi që janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të paraparë me nenin 152 të LPK-së me të cilin përcaktohet se “Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”. Kjo pasi që është vërtetuar se pala e dëmtuar A.Sh. “V.”, me seli në Prishtinë, me pronar F.Sh., pranë paditëses ka paraqitur kërkesë për kompensim dëmi. Paditësja në procedurë jashtëgjyqësore ka arritur Ujdi Jashtëgjyqësore me palën e dëmtuar, FK nr.1307/13, datë 02.08.2013, për shumën prej 653.00 euro, në emër të demit material për automjetin e dëmtuar në aksidentin e datës 15.06.2013, dhe paditësja me datën 15.08.2013 i ka kompensuar dëmin në lartësi prej 653.00 euro. Duke u mbështetur në rregullativën në fuqi sipas dispozitave të LSDA 2011 dhe LMD-së së vitit 2013 paditësja ka qenë e obliguar që të përmbushë detyrimin ndaj palës së dëmtuar, duke i kompensuar dëmin e shkaktuar nga i siguruari i saj. Bazuar në nenin 960 par. 1 të LMD – së 2013 është përcaktuar se: “Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit, kundërt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo bazë janë përgjegjës për dëmin“ dhe e cila e drejtë fitohet në bazë të nenit 18 të LSDA 2011, i cili përcakton se: “pas pagimit të dëmshpërblimit, mund të bëhet rimbursimi i shumës së paguar, në bazë të kërkesës për regres nga pronari apo shfrytëzuesi i regjistruar i automjetit i cili nuk ka siguruar automjetin duke llogaritur kamatën dhe shpenzimet“. I padituri në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë i pa siguruar, respektivisht i kishte skaduar afati i periudhës së sigurimit dhe për këtë paditësja ka të drejtë që mjetet e paguara nga kjo bazë t’i regresojë drejtpërdrejt nga shkaktari i aksidentit. Vendimin mbi kamatën e ka bazuar në nenin 277 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e ka bazuar në nenin 450 të LPK-së duke vendosur që secila palë t’i bart shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar, nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i kanë pretenduar palët ankuese me ankesë

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurit së aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat pretendon pala ankuese. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye

të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e shqyrtuara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit, vlerëson së nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit së gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që e njëjta vendimin e ka bazuar në provat të cilat paditësja ia ka bashkangjitur padisë bazuar në nenin 152 të LPK-së, ndërsa i padituri edhe përkundër kontestimit të kërkesëpadisë i njëjti nuk i ka kontestuar faktet vendimtare që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të atakuar. Në bazë të raportit të aksidentit 2013-AR-1687, rezulton së shkaktar i aksidentit të datës 15.06.2013, i cili ka ndodhur në K., Podujevë, ka qenë i padituri, ku në këtë rast pala e dëmtuar A.Sh. “V.”, me seli në Prishtinë, ka pësuar dëm material në automjet. Në momentin e aksidentit automjeti VW Golf , me targa ..., të cilën e drejtonte i padituri nuk ka pasur policë valide të sigurimit, pasi që polica e sigurimi i kishte skaduar me datë 18.04.2013, i cili fakt vërtetohet nga konfirmimi i sigurimit i datës 22.07.2013. Për me tepër, fakti së i padituri ka qenë shkaktar i aksidentit të datës 15.06.2013, dhe së automjeti të cilin i njëjti e drejtonte ka qenë i pasiguruar nuk është kontestuar nga i paditura as përmes përgjigjes në padi dhe as përmes ankesës.

Po ashtu sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit së gjykata e shkallës së parë ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që në bazë të nenit e nenit 18 par.1 të Ligjit nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia përcaktohet se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësisë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”*. Kurse me par.4 të po këtij neni parashihet se: *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*. Ndërsa në bazë të nenit 136 par. 1 të Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, është paraparë së *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*.

Në bazë të dispozitës së sipërcituar, paditësja është përgjegjëse për kompensimin e dëmit personave të dëmtuar nga automjetet pronaret e të cilëve nuk janë të mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësisë. Në rastin konkret në bazë të Ujdisë Jashtëgjyqësore me numër të lëndës FK-1307/13, të datës 02.08.2013, dhe transferit bankar të datës 15.08.2013, është vërtetuar së paditësja e ka kompensuar palën e dëmtuar në aksidentin në fjalë në shumën prej 653.00 euro, andaj e njëjta ka të drejtën e regresit ndaj të paditurit si person përgjegjës për shkaktimin e dëmit dhe atë për shumën e paguar dhe kamatën. Gjykata vlerëson se i padituri ka për detyrë që ta bëjë kompensimin e dëmit të cilin e ka shkaktuar në aksident, pasi që automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti nuk ka pasur sigurim. Andaj bazuar në dispozitat e lartcekura Gjykata e Apelit vlerëson së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Lidhur me pretendimin e të paditurit të paraqitur në ankesë sa i përket parashkrimit të kërkesës, Gjykata e Apelit vlerëson së i padituri këtë pretendim ka pasur mundësi ta paraqet përmes përgjigjes në padi, pasi që sipas nenit 180 par.3 të LPK-së, prapësimi i parashkrimit që nuk është paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë. Prandaj, bazuar në

këtë dispozitë, Gjykata e Apelit, nuk e mori parasysh prapësimin e të paditurit sa i përket parashkrimit të kërkesës.

Vendimi për kamatën është i drejtë pasi që gjykata e shkallës së parë ka vepruar sipas kërkesës së palës paditëse e cila në petitumin e padisë kamatën e ka kërkuar sipas mjeteve të deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, kamata është dashur të gjykohet bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, i cili ligj ka qenë në fuqi në kohën e shkakimit të aksidentit dhe pagesës së dëmit palës së dëmtuar, ndërsa lartësia e kamatës të gjykohet brenda kufijve të kërkesës së palës paditëse siç ka ndodhur në rastin konkret.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4070/2021, datë 18.03.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari
Hysni Bardheci